

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 02 / 08 / 2025		
Nr. Orgj. Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 81	Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.81
Data: 29.08.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt me Nr. 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës me datën 29.08.2025 miratoi këtë:

VENDIM PËR MIRATIMIN E ANËTARSIMIT NË “ACES EUROPE”

I

MIRATOHET; Propozimi i Kryetarit të Komunës së Ferizajt, i cili propozim evidentohet me numër 329/25 të datës 28.08.2025 për Anëtarimin në “ACES EUROPE”

II

Qëllimi i anëtarimit në këtë Shoqatë “ACES EUROPE” me seli në Belgjik-Bruksel është promovimi i politikave sportive evropiane përmes dhënies së çmimeve ndërkombëtare, përfaqësuar nga Presidenti dhe themeluesi z.Gian Franceco Lupattelli.

III

Sa i përket anëtarimit në “ACES EUROPE”, Komuna e Ferizajt ka obligime financiare për arritjen e kësaj marrëveshje në shumën minimale prej 10,000.00 (dhjetë mijë euro), siç rreguhet edhe me nenin 26.4 të rregullave të përgjithshme të “ACES EUROPE”.

IV

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit Ferizaj, si dhe Kuvendi i Komunës, ndërsa autorizohet kryetari për lidhjen e marrëveshjes në mes të komunës dhe kësaj shoqate.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalesë / Izlaze: Date / Dana: 02.09.2025		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 82	Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.82
Data: 29.08.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës Ferizaj me Nr.01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës me datën 29.08.2025 miratoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE PËR RAJONIN E GJILANIT DHE FERIZAJT, SI DHE DRAFT VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR (VSM) PLANEVE NDËRKOMUNALE PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE PËR KOMUNAT; GJILANIT, KAMENICËS, VITISË, NOVOBËRDËS, PARTESHIT, KLLOKOTIT, RANILLUG, FERIZAJ, KAÇANIK, SHTIME, HAN I ELEZIT DHE SHTËRPECË.

I

MIRATOHET; Propozimi i Kryetarit të Komunës së Ferizajt, i cili evidentohet me Nr.188/2025 i datës 14.07.2025 për Miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, si dhe Draft Vlerësimin Strategjik mjedisor (VSM), planeve ndërkomunale për menaxhimin e integruar të mbeturinave për Komunat; Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Parteshit, Klllokotit, Ranillug, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Han i Elezit dhe Shtërpçë.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe Drafti final i këtij Plani, i cili rregullon menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe i cili i ka kaluar fazat e dëgjimit publik dhe të gjitha procedurat ligjore.

III

Për realizimin e këtij Plani përkujdesen: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencia, Kryetari dhe Kuvendi i Komunës Ferizaj.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 02.09.2025		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 83	Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.83
Data: 29.08.2025

Në bazë të nenit 12 dhe nenit 40, paragrafi 40.2, e Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr, 28/04 Qershor 2008) Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 25 paragrafi 2, pika 2.9, neni 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, si dhe Ligjit Nr. 04/L-179 për Transport Publik, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.08.2025 miratoi këtë:

VENDIM PËR SUBVENCIONIMIN E TRANSPORTIT URBAN DHE URBANO – PERIFERIK

I

Ky Vendim ka për qëllim të përcaktoj kushtet dhe procedurat e subvencionimit të transportit urban dhe urbano - periferik në Ferizaj.

II

Transporti urban dhe urbano - periferik do të subvencionohet nga Komuna e Ferizajt në euro për kilometër (€/km), të cilat do të llogariten në bazë të rrethit të udhëtimit të cilat janë të vërtetuara nga organi kompetent.

Subvencionimi bëhet në vlerë prej € për kilometër (€/km), ku tarifa për transportin urban është 0.60 €/km, ndërsa për transportin urbano - periferik është 0.40 €/km.

III

Ky subvencion është i planifikuar të zbatohet për një periudhë pesë vjeçare me mundësi vazhdimi.

IV

Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë emëron një komision për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të arritura në departamentin e transportit pas thirrjes publike për subvencionimin e transportit urban dhe urbano - periferik.

V

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë ka përcaktuar që në kuadër të programit të subvencionimit të përfitojnë disa kategori të caktuara për bileta ditore dhe mujore. Këto kategori përfshijnë: nxënësit, studentët, pensionistët, personat e dalë nga lufta, familjet me asistencë sociale si dhe personat me nevoja të veçanta.

VI

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Drejtoria për shërbime publike dhe emergjenca, Kryetari dhe Kuvendi i Komunës Ferizaj.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi